

VENDIM
Nr. 686, datë 22.10.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 290, DATË 14.5.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E FONDEVE BUXHETORE DHE TË RAPORTIT
TË PËRBASHKËT TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT,
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE
MINISTRISË SË FINANCIVE, PËR REALIZIMIN E PLATFORMËS
MULTIMEDIATIKE “BRANDING ALBANIA””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “b”, e pikës 3, të vendimit nr. 290, datë 14.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b. Faza e dytë, me vlerë 500 000 (pesëqind mijë) euro, do të realizohet pas lidhjes së kontratës me kompaninë fituese dhe do të përballohet nga fondi i kontingjencës për vitin 2014.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama